

HIXHABI ËSHTË NDER E RUAJTJE E TRADITËS

E falenderojmë Allahun që na ka krijuar dhe na ka urdhëruar më fjalën e Tij Kur'anin ku thuhet: “O ti Pejgamber, thuaju grave tua, bijave tua dhe grave të besimtarëve le të vejnë shamitë (mbulojë) e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen (se nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen. All-llahu falw gabimet e kaluara, Ai është mëshirues”. [el-Ahzab:59]

Pejgamberi e ka porositur Ibën Abbasin kur ky ishte ende i vogël me këto fjalë: “Djalosh! Po t’i mësoj disa fjalë: Ruaje (respektoje etj.)

All-llahun e Plotfuqishëm dhe Ai të ruan ty; ruaje (respektoje etj.) All-llahun, do ta gjesh në anën tënde! Kur të kërkosh, kërkko nga All-llahu; e kur të nevojitet ndihma, kërkko nga All-llahu! Dhe dije se poqëse i gjithë populli mblidhet për të të bërë një të mirë, nuk do të kenë mundësi të të bëjnë asnjë të mirë që nuk ta ka caktuar All-llahu; dhe sikur të mblidhet gjithë populli për të bërë një të keqe që nuk ta ka caktuar All-llahu, nuk do të kenë mundësi të bëjnë asnjë të keqe. Janë tharë lapsat dhe janë ngrihur fletët.”

Motra te nderuara!

Gjatë takimit me dikë si i dalim përpara.?Me ndonjë mik apo shok apo shoqe që e duam !.Apo njeri autoritativ!.Apo edhe që ngushtohemi prej tij.?Si do te dalim para njeriut?...

Esenca e kësajë qëndron Se:Ne nganjëherë nuk mundë ta godasim apo t’ia qëllojmë gardarobës së pëlqyer nga ai që duam ta takojmë.P.sh.Kur duam të takohemi me ndonjë njëri të madhe të ditur mundë të vishemi me mini por ndodhë që ai nuk na pëlqen atë veshje.Me babin të dashurin me këdo tjetër ne do të dëshiroinim që të vishemi ashtu sië i pëlqejmë Atij.Por ku ta dijmë?

Po para Allahut që i ka të gjitha cilësitë më të mira para të cilit me trup e shpirtë jemi te knaqur turpërohem dhe kemi dëshirë të dalImi sië Ai ka thënë vetë.Ashtu sië e cekëm në fillim thënjen e Tij.

Pa dyshim se Namazi është takimi me Allahun e lartësuarë e nëse nuk jemi të veshura gjithëherë ashtu si porositë Allahu xh.sh. së paku derisa falemi si mendojmë në plotësimin dhe realizimin e duave lutjeve dhe dëshirave tona të pa kufijshme.Ato mundë të jenë të kota bile edhe nuk na pranohen fare,si namazi dhe të tjerat.Poqëse nuk jemi të mbuluara.

-Si besimtare musimane kërkohet të jemi të mbuluara në tërësi me shami e hixhab sepse kështu urdhëron Ai subhanehu ve teala.

Për të folur për shamijn apo mbulesen na nevojitet shumë hapsirë po cekim shkurtimisht disa gjëra lidhur me veshjen normale të njeriut në përgjithësi si dhe të femrës në veçanti.

Allahu ka porositur të gjithë njerëzit që të mbulojnë trupin e tyre të vishen mirë pastër e bukur gjithëherë e sidomos kur shkojmë në xhami

Veshja si cilësi mbrojtëse edukativo morale e njeriut gjithashtu është edhe ndër elementet që e dallon nga gjallesa tjera që mbulimin e trupit të tyre „veshjes“ e kane natyrale instiktive, por tek njeriu posedues i nderit moralit edukatës e logjikës është shkon edhe më tej, sepse njerëzit dallohen edhe nga vetë soji i tyre me pamjen veshjen ashtu si edhe sjelljen e tyre. Edhe gjendje profesionale apo edhe moment ka veshjen karakteristike të preferueshme ashtu siç i themi tek ne uniformë. Veshja sipas mësimëve kur'anore është uniformë e muslimanit apo muslimanes e Allahu i Madhërueshëm na ka sqaruar se veshja e devotshmerisë është ajo që tregon personalitetin e plotë të të qenurit njeri.

Është e qartë nga Kur'ani Fjala e Allahut xh.sh dhe nga Sunneti fjalë e Pejgamberit a.s. që hixhabi është një obligim fetarë-Farz. Nuk ka ndryshime në mendime (ihtilaf) mbi këtë pikë dhe Ummeti musliman e ka aplikuar atë për më se 15 shekuj. Por jo vetëm kaq, sepse mbulimi i trupit për femrën simbolizon moralin që nga kohërat e vjetra edhe para shpalljes së Kur'anit gjejmë argumente se si gratë e ndershme e fetare kanë bartë shami.

Lirishtë mund të themi një fjali të një dietari gjerman i cili u pyet nga një gazetarë pse gruaja e juaj ka shami a rrjedhë prej familjes krishtere sikurse ju? Ai i tha. A ka ndokush ndonjë argument se mejremit Maris nënes së Jezusit ia ka parë dikush flokët. Dhe gazetarja heshti. Kur një grua muslimane vesh hixhabin ajo është duke ju bindur Allahut krijues dhe traditën e vjetër të gjithë njerëzimit simbolin e dashurisë ndaj Krijuesit dhe simbolin e moralit për gjithë njerrëzimin.

T'i thuash asaj që të heqi është njësoj sikurse t'i thuash asaj që mos i falë namazet. Do të thotë i thua ndërprejë lidhjet me Allahun shkeli urdhërat e Tij mos e dëgjo Allahun. Kjo çështje nuk mund të merret me lehtësi përderisa është e përfshirë midis gjynaheve më të mëdha në islam. Fatkeqësisht, dikush mund të gjejë gra muslimane të cilat debatojnë që hixhabi nuk është obligim, Ky është një gabim i madh përderisa është mohimi i vargjeve kur'anore dhe shtrembërimi i tyre për të përmbushur dëshirat personale. Ajetet e më poshtme të Kur'anit të shenjtë i referohen natyrës obliguese të hixhazit: “Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le të vejnë shamitë mbi krahorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet, babajve të vet ose babajve të burrave të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllazërve të vet ose djemve të vëllazërve të vet, apo djemve të motrave të veta, ose grave të tyre (që u përmenden) dhe robreshave, të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbetorëve nga meshkujt të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat ose fëmijët nuk kanë arritur pjekurinë për gra. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë te All-llahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim”. [Nur:31]

Për ta vërtetuar thënjen se edhe në fetë tjera ka shamij e hixhab u sjellim dy nga citatet biblike nga bibla krishtere, Nr 1 e Korintasve: ”Edhe çdo grua, që lutet

ose profetizon kokëzbuluar, turpëron kryet e saj, sepse është njëloj sikur të ishte e rruar. Sepse në qoftë se gruaja nuk mbulohet, le t'ia presin flokët; por në qoftë se për gruan është turp të qethet a të rruhet, le të mbulojë kryet” Andaj një pyetje interesante duhet të bëhet: “Pse është një murgeshë e respektuar për veshjen e saj modeste por një muslimane e veshur me hixhab është e shikuar si e shtypur?” Më trishton të shikoj si gratë myslimane portretizohen si të “shtypura” të botës myslimanë. Është e çuditshme sesi pamja e një murgeshe e mbuluar këmbë e krye në mënyrë që t’i përkushtohet Zotit është e respektuar dhe e shikuar si e devotshme dhe një grua fetare. Por kur një grua myslimane zgjedh të mbulojë flokët e saj dhe të veshë rroba të gjata dhe të gjëra ajo shikohet si e “shtypur”. Njerëzve ju është mbushur truri nga mediat për të besuar që ajo kurrë nuk do të zgjidhte këtë stil veshjeje, andaj edhe nuk pij ujë në burimin e pastërt Kur’anin që ta shohin ë’ është kulturë ngritje personalitet dhe edukim gjithë njerëzorë. Prandaj nëse ke hixhab rrespekton fetë jo vetëm islamin e nuk duhet të jemi të ndikuara nga mediat e njerëzit e pa informuar. Muhamedi a.s me një rastë i ka thënë Esmas ”Kur femra të hyje në moshën madhore duhet të mbulohet“.

Një këndë tjetër që vlenë të cekët këtu është edhe marrja- turpi veti e mirë e njeriut besimtare pa varësishtë gjinin. Por është dhe duhet të jetë më e theksuar për femrat pra që nga koha e pubertetit, moshës madhore apo sië i thojn tek ne bylyku e cila kohë fillon me fillimin e menstruacioneve.

Turpi është një degë prej degëve të imanit, siç transmetohet nga Pejgamberi a.s.”Atij që i pakësohet turpi, i pakësohet edhe imani”-besimi në Allahun. Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, ka thënë: "Turpi, vetëm të mirën ta sjellë."

Quditem se si vajzat e reja por edhe grat nuk kanë turp dhe nuk u vie marre që gjysëmlakuriq i sheh babi i vet vellau i vet e le më ndonjë njeri i pa njofshëm e në rrugë!

Fëmijët tanë u nënshtrohen dita-ditës pasojave të “revolucionit seksual” nëpërmjet TV-së, kinemasë, videove, internetit, gazetave, revistave, librave dhe shoqërisë. Mendja e tyre e re ushqehet me idenë se morali, kujdesi dhe vlerat kanë dalë nga moda. Nëse nuk u themi atyre se jeta në të vërtetë është krejt ndryshe, dhe nëse nuk u bëjmë të qartë atyre se ç’është e pranueshme nga pikëpamja kulturore dhe ç’është e rëndësishme nga pikëpamja islame, do të mbajmë përgjegjësi në qoftë se fëmijët do të binin viktimë të batakut imoral të seksit, drogave, shtatzanisë së padëshiruar, prostitucionit, alkoolit etj. qofte edhe para Allahu krijues që ruajtjen e vetvehtës dhe familjes e ka bërë urdhër shejtëri „Ruajeni vetvehten dhe familjen e juaj nga zjarri“

Andaj ua them një Këshillë për bijën adoleshente, të cilën duhet ta mbani mirë në mendë dhe t’ua tregoni atyre që i takoni e që i parkasin kësaj moshe sepse e keni borgj.

Trupi yt i nënshtrohet ndryshimeve të cilat të përgatisin për faktin e të qenit grua. Me ndryshimet, një ditë vjen dhe përgjegjësia e të qenit nënë. Trupi yt bëhet objekt i ndryshimeve të mëdha si p.sh. madhësia e gjinjve, fytyrës, gjatësisë, peshës si dhe fillimi i hemoragjisë së rregullt gjatë menstruacionit mujor – kësaj s'ke pse i trembesh; kjo s'është gjë tjetër veçse një mrekulli e Allahut të Madhërueshëm, ndërsa mitra jote përgatitet çdo muaj të presë vezoren e fekunduar.

Kjo nuk është asgjë e tmershme që shumë herë nënat e pa ngritura islamikisht apo intelektualisht e presin si gjë të keqe në fakt kur lajmërohen menstruacionet duhet të priten me gëzim sepse ato janë shenjë e pjekurisë, mundësisë për të lindur e për të qenë nënë apo edhe fillimin e etapës së femërores të cilës edhe i takojmë.

Duhet të jesh e kënaqur me trupin tënd. Ai po kalon në fazën të ndryshimeve hormonale që ndikojnë tek gjendja jote emocionale. Kjo është një periudhë e konflikteve të shpeshta. Por e jotja vajzë e re është që ta mbulosh trupin tënd që "tregtarët" mos të vrenjë shpejtë këtë dhe të vërsulen. Ruajtja e trupit tënd është shenjtëri obligim nderë kulturë e ngritje të njerëzimit por edhe tek Allahu që na ka kriuar dhe para Tij kemi me dhënë llogari.

Prindërit duhet të jenë të ndërgjegjshëm dhe duhet të diskutojnë me durim, mirëkuptim dhe dashmirësi për temën të ndryshme. E rëndësishme është që të mos bëhesh pre e presionit të shoqërisë të cilët të tundojnë në rrugën e eksperimentimit të puthjeve apo marrëdhënieve seksuale. Bile, disa "shokë" do të përpiqen të të hedhin në shaka apo të të izolojnë nëse nuk bëhesh pjesë e tyre. Mos i dëgjo ata! Duhet të besosh fort tek udhëzimet e Allahut të Madhërueshëm dhe t'u përgjigjesh shokëve thjeshtë: „Jo, mua kjo s'më intereson.“ Nuk do të pendohesh kurrë për këtë veprim. Shmangiu sidomos djemve apo burrave më të moshuar se ti. Ata do të përpiqen të të joshin me dhurata, lule apo premtime boshe dashurie. Në fakt ata në këtë mënyrë hedhin grepat për të të shtënë në grackën e krevateve të tyre, ku ti mund të humbësh ndershmërinë tënde, për të të hedhur më pas si limon i shtrydhur, në kërkim të një viktime tjetër naive.

Kështu ti mund të humbasësh shumë: - Humbet nderin, - Thyen udhëzimet e Kuranit dhe Synefit për ndalimin e seksit jashtë martesë, - Mund të ngelesh shtatëzënë kundër vullnetit (shumë femra mendojnë gabimisht se s'mund të ngelin shtatëzënë menjëherë pas përvojës së parë seksuale),

- Mund të infektosh me ndonjë sëmundje seksuale (përfshi dhe HIV/SIDA). Për disa prej këtyre sëmundjeve nuk ka ende mjekim (si p.sh. herpes, etj). Disa prej këtyre sëmundjeve nëse nuk kurohen me vëmendje, mund të shkaktojnë shterpësi dhe ti kurrë nuk mund të lindësh fëmijë më pas; apo akoma më keq, mund të të shfaqet kanceri i mitrës.

Rreziqet e shumta të presin poqëse nuk iu përmbahesh këshillave të krijuesit të gjithësisë.

Andaj për t'i parandaluar apo thënë në mënyrë tjetër "parandalimi është më i mirë se shërimi" që në startë duhet ti marrësh masat e nevojshme që të mos vije deri

tek sëmundja prishja e nderit hudhja e vetvehtës në humnerë.Pa farë dyshimi preventiva më e mirë e lehtë obliguese dhe edukativo morale është mbulimi i trupit veshja që në terminologjinë islame e quajn hixhab.

Dikush mendon nën ndikimin e propagandave anti islame e anti kombëtare shqiptare se ta vëshë shamijnë je mbrapa apo edhe kundër traditës kombëtare.Por kjo është një virus i disave nga shoqëria jonë sepse të gjithë e dijnë se veshja kombëtare shqiptare ka shamijn kmishen e fustanin.Kjo nuk do koment por vetëm se të themi femra që bartë shamij mbron ruan vetvehtën traditen morale të gjithë njerzimit ashtu si edhe atë kombëtare shqiptare.

Lusim Allahun xh.sh. që të na mundësoi njohjen e së vërtetës udhëzimit kah e mbara dhe shmangjen nga të pa vërtetat .AMIN

Lusim Allahun që të na mundësoi ruajtjen e nderit kulturës e traditës sonë fetare e kombëtare.AMIN

Lusim Allahun e lartësuarë që të na mundësoi jetë të qetë si besimtare dhe në ahiret të na tkaoi met ë dashurit met ë sinëertit shehidët e Pëejgamberët.

AMIN AMIN AMNIN VELHAMDU LILAHI RABIL ALEMIN.